

VENDIM
Nr.1323, datë 1.10.2008

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA ARMO SHA-JA, TIRANË, BASHKISË KUÇOVË, TË
ISH-UZINËS SË PËRPUNIMIT TË NAFTËS, KUÇOVË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.208, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN
E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ARMO SHA-SË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga ARMO sh.a.-ja, Tiranë, bashkisë Kuçovë, të pronës me numër rendor 32 “Ish-uzina e përpunimit të naftës, Kuçovë”, për ndërtimin e parqeve dhe të zonave rekreative.
2. Prona me numër rendor 32 “Ish-uzina e përpunimit të naftës, Kuçovë”, të hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr.208, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave.
3. Ky ndryshim të reflektohet në vendimin nr.662, datë 8.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Kuçovë, të qarkut të Beratit”.
4. Ngarkohen Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ARMO sh.a.-ja, bashkia Kuçovë dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Shoqëria "ARMO" sh.a. Fier				Identifikoi: ThanasMuçaj, specialist i zyrës së privatizimit (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
Bashkia: Kuçovë				Supervizoi: Gëzim Shahini, shef i zyrës së privatizimit (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
Fusha e përdorimit të pronës: Përpunimi dhe tregtimi i nënprodukteve të naftës				Aprovoi: Përparim Hajnaj drejtor i përgjithshëm i shoqërisë "ARMO" sh.a. (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel 03423931)						
A			B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Uzina e përpunimit të naftës Kuçovë bashkia Kuçovë		Bashkia Kuçovë	250205 m ²	Përpunimi i naftës bruto	MLE Tiranë "ARMO" sh.a. Fier	"ARMO" sh.a. Fier QSHKP Kuçovë	Nuk është në funksionim
32				-Garazh i automjeteve		56 m ²	"	"	"	
				-Kënd i kuq		149 m ²	"	"	"	1 kate
				-Zyra e faturimit në dalje		21 m ²	"	"	"	1 kate
				-Magazina e vajit		56 m ²	"	"	"	1 kate
				-Magazina nr.1		173 m ²	"	"	"	1 kate
				-Dushe garderoba		251 m ²	"	"	"	1 kate
				-Mencë		110 m ²	"	"	"	1 kate
				-Ish - muzeu		100 m ²	"	"	"	1 kate
				-Mastika bituminoze		184 m ²	"	"	"	1 kate
				- Laboratori qendror		215 m ²	"	"	"	1 kate
				- Dhoma e rojës		15 m ²	"	"	"	2 kate
				- Dhoma e faturimit		11 m ²	"	"	"	1 kate
				- Dhoma e vjetër e rojës		22 m ²	"	"	"	1 kate
				- Dhoma antidode		30 m ²	"	"	"	1 kate
				- Salla e komandës dhe laborator i gazit		14 m ²	"	"	"	1 kate
				-Kabinë elektrike dhe salla e pompave		330 m ²	"	"	"	1 kate
				- Kulla e ftohjes		137 m ²	"	"	"	1 kate
				- Garederoba e fabrikës		96 m ²	"	"	"	1 kate

